

GJYKATA E APELIT

Numri i lëndës: PAKR 1122/2012

Më: 25 prill 2013

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS në kolegjin e përbërë nga gjyqtarja e EULEX-it Annemarie Meister si kryetare dhe gjyqtare raportuese, nga gjyqtari Tore Thomassen (EULEX) dhe gjyqtarja Tonka Berisha si anëtarë të kolegjit, në pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor të EULEX-it Clemens Mueller,

Në lëndën penale kundër të akuzuarve:

K.P., (...) me profesion avokat, me gjendje financiare mesatare, i martuar, baba i tre fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës;

L.P., (...) me profesion avokat, me gjendje financiare mesatare, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës;

B.B., (...) doktor – ortoped / traumatolog, me gjendje financiare mesatare, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës;

I.S., (...) me profesion avokat, me gjendje financiare mesatare, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës;

I akuzuar me aktakuzën PPS 120/10 e ngritur nga prokuroria speciale për veprat penale krim i organizuar sipas nenit 274 (1) dhe (2) të Kodit Penal të Kosovës (më tutje në tekst ‘KPK’), në lidhje me L.P, B.B. dhe I.S. dhe me nenin 274 (1) dhe (3) të KPK-së lidhur me K.P., për veprat penale të sipas nenit 339 (1) dhe (3) të KPK-së dhe të nxjerrjes së kundërligjshme të vendimeve gjyqësore, sipas nenit 346 të KPK-së;

K.P., L.P. dhe B.B. janë shpallur fajtorë me aktgjykimin P. nr. 477/11 të datës 24 maj 2012 të Gjykatës së Qarkut të Pejës si më poshtë:

K.P. për veprën penale të Shpërdorimit të pozitës zyrtare ose të autorizimit sipas nenit 339 (1) dhe (3) të KPK-së; është dënuar me burgim prej pesë (5) vjetësh dhe në bazë të nenit 54 (1) dhe (2), nënparagrafit 3 dhe nenit 56 (2) të KPK-së, i është shqiptuar dënimi plotësues i ndalimit të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për periudhën kohore prej tre vjetësh;

L.P. për veprën penale të Mashtrimit sipas nenit 261 (1) dhe (2) të KPK-së; është dënuar me burgim prej tre (3) vjetësh; dhe në bazë të nenit 54 (1) dhe (2), nënparagrafit 4 dhe nenit 57 (1) dhe (2) të KPK-së, i është shqiptuar dënimi

plotësues i ndalimit të ushtrimit të profesionit, të aktiviteteve ose të detyrës për periudhën kohore prej tre vjetësh;

B. B. për veprën penale të Mashtrimit sipas nenit 261 (1) dhe (2) të KPK-së; është dënuar me burgim prej gjashtë (6) muajsh, dënim ky i cili nuk do të ekzekutohet në qoftë se i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale gjatë periudhës kohore prej dy (2) vjetësh; dhe në bazë të nenit 54 (1) dhe (2), nënpar. 4 dhe nenit 57 (1) dhe (2) të KPK-së, i është shqiptuar dënimi plotësues i ndalimit të ushtrimit të profesionit, të aktiviteteve ose të detyrës për periudhën kohore prej tre vjetësh;

I. S. është liruar me aktgjykimin P. nr. 477/11 e datës 24 maj 2012 të Gjykatës së Qarkut të Pejës;

Duke vendosur rreth këtyre ankesave të parashtruara ndaj aktgjykimit P 477/11, të parashtruar pranë Gjykatës së Qarkut të Pejës:

- Ankesa e parashtruar nga prokurori special Ali Rexha më 11 korrik 2012,
- Ankesa e Avokatit mbrojtës Destan Rukiqi e parashtruar në emër të të pandehurit B. B. më 10 korrik 2012,
- Ankesa e të pandehurit L.P. e parashtruar më 12 korrik 2012,
- Ankesa e Avokatit mbrojtës Rame Gashi e parashtruar në emër të të pandehurit L. P. më 12 korrik 2012,
- Ankesa e të pandehurit K.P., e parashtruar më 15 korrik 2012;

Pas shqyrtimit të përgjigjes së dhënë nga prokuroria e shtetit e Kosovës nr. PPA 457/12, e datës 24 tetor 2012;

Pas mbajtjes së seancës publike më 25 prill 2013 në praninë e të pandehurve dhe të avokatëve mbrojtës Gezim Kollçaku, Ramë Gashi, Destan Rukiqi, Merita Bajrajtari dhe të prokurorit të apelit të shtetit Xhevdet Bislimi;

Pas mbajtjes së këshillimit dhe votimit më 25 prill 2013,

Në bazë të nenit 420 dhe neneve në vazhdim të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK)

Merr këtë:

AKTGJYKIM

- **Ankesa e prokurorit special ndaj aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Pejës (lënda nr. P 477/11, e datës 24.05.2012) PRANOHET ndërsa aktgjykimi ANULOHET në**

pjesën me të cilën lirohet i pandehuri I.S. Lënda kthehet në Gjykatën Themelore të Pejës për rigjykim ndaj të pandehurit I. S.

- **Ankesat e të pandehurit L. P., të pandehurit K.P., të avokatit mbrojtës Destan Rukiqi, të parashtruar në emër të të pandehurit B.B., të avokatit mbrojtës Ramë Gashi, të parashtruar në emër të të pandehurit L.P., ndaj aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Pejës (P nr. 477/11, të datës 24.05.2012) REFUZOHEN si të pabaza. Të pandehurve u mbeten dënimet e shqiptuara nga ana e Gjykatës së Qarkut të Pejës.**
- **Gjykata e Apelit, duke vepruar sipas detyrës zyrtare, e NDRYSHON aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Pejës (lënda nr. P 477/11, e datës 24.05.2012), lidhur me dënimin të pandehurit K.P., për veprën penale të Shpërdorimit të pozitës zyrtare ose të autorizimit si më poshtë:**

K. P.

SHPALLET FAJTOR

Për veprën penale të nxjerrjes së vendimeve të kundërligjshme gjyqësore sipas nenit 346 të KPK-së ngase në mes të datës 12 shtator 2007 dhe 8 prill 2008 në Klinë, K. P. në cilësinë e gjyqtarit të Gjykatës Komunale të Klinës dhe L. P. si avokat, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm material për veten e tyre, sajuan një plan për paraqitje të kërkesës për kompensim pranë Gjykatës Komunale të Klinës në emrin e F. G. ndaj Fondit Garantues të Kosovës për kompensim të lëndimeve personale gjoja të pësuar nga i lartpërmenduri F. G. në një aksident trafiku rrugor i cili kishte ndodhur në mes të një kamioni të pasiguruar të ngarë nga G. D. dhe automjetit motorik Audi të ngarë nga L. S. dhe automjetit motorik Audi të ngarë nga Q.G. më 13 shtator 2006 në fshatin Radullovc, komuna e Klinës. K. P. e dinte se F. G., duke qenë udhëtar në automjetin motorik të ngarë nga by Q.G., kishte pësuar vetëm lëndime të lehta. Megjithatë, pa dijen, autorizimin apo pëlqimin e të lartpërmendurit F. G., në marrëveshje me K. P., më 12 shtator 2007, L. P. kishte nisur procedurën pranë Gjykatës Komunale të Klinës kinse në emër të F. G. Kjo procedurë ishte regjistruar me numër të lëndës C. nr. 271/07. K. P. e dinte se F. G. nuk kishte pësuar lëndimet e pohuara në atë kërkesë. K. P. ishte marrë vesh tinëzisht me L. P. që atë kërkesë ta ndiqnin penalisht pranë Gjykatës Komunale të Klinës me kryetar të trupit gjykues vetë K.P., duke i dhënë kështu legjitimitet të jashtëm planit të tyre.

K. P. kishte caktuar B. B. të shkruante raportin mjekësor, kinse në emër të F. G.. K. P i kishte thënë B. B. se nuk kishte nevojë ta ekzaminonte F. G.

Më 8 prill 2008 K. P. po kryesonte shqyrtimin në Gjykatën Komunale të Klinës gjatë së cilës L. P. gjoja po përfaqësonte F. G., në të cilën I.S. po përfaqësonte Fondin Garantues

të Kosovës. L. P. i thotë I. S. se nuk do të pranonte ofertë më të ulët sesa 16.000 euro si zgjidhje të kërkesëpadisë. Kjo ishte ajo për të cilën ishin pajtuar K.P. me L. P.. Raporti mjekësor i datës 6 shkurt 2008 nga B. B. si dhe raporti financiar i datës 3 mars 2008 i A. B. u paraqitën si prova. Në emër të Fondit Garantues të Kosovës, I.S. kishte propozuar ofertën për zgjidhje të padisë në vlerë prej 16.000 eurosh. L. P. u shtir kinse po merrte udhëzimet nga F. G. dhe më vonë pranoi ofertën në fjalë si zgjidhje. Si kryetar i trupit gjykues K. P. miratoi zgjidhjen në fjalë duke nxjerrë vendim të kundërligjshëm gjyqësor, përkatësisht vendim me të cilin miratonte marrëveshjen për zgjidhjen e kërkesëpadisë për kompensim në shumë prej 16.000 eurosh plus shpenzimet në vlerë prej 800 eurosh.

Më 23 prill 2008 L. P. ka pranuar në xhirologari të vet në ProCredit Bank një transferim bankar prej Fondit Garantues të Kosovës në shumë të përgjithshme prej 16.800 eurosh si zgjidhje e pajtueshme për dëmet e shkaktuara. Më 25 prill 2008 L. P. i dha K. P. shumën prej 16.000 eurosh në të holla të gatshme duke ndaluar për vete shumën prej 800 eurosh.

Për këtë arsye, i akuzuari K. P.

DËNOHET

Me pesë (5) vjet burgim për veprën penale të Nxjerrjes së vendimeve të kundërligjshme gjyqësore, në kundërshtim me nenin 346 të KPK-së.

Në bazë të nenit 391 (5) të KPPK-së, dënimi përfshin kohën të cilën i akuzuari tashmë e ka kaluar në mbajtje para gjykimit derisa ishte dënuar me burgim me vendim të gjykatës së shkallës së parë dhe të vërtetimit të ankesës.

- **Propozimi për ndërprerjen e masës së paraburgimit, i paraqitur nga ana e avokatit mbrojtës Gezim Kollçaku në emër të të pandehurit K.P., REFUZOHET si i pabazë.**

ARSYETIM

I. Procedura e mëhershme

1. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (tash e tutje në tekst PSRK, prokurori special) ka parashtruar pranë (asokohe) Gjykatës së Qarkut të Pejës aktakuzën nr. PPS 120/10 të datës 10.08.2011 ndaj këtyre të pandehurve: K.P., L. P., B. B., dhe I. S. Aktakuza në fjalë pohonte se të pandehurit bartnin përgjegjësi penale për krim të organizuar sipas nenit 274 (1) dhe (2) të KPK-së kur kemi të bëjmë me të pandehurit L. P, B. B., dhe I. S. ndërsa sipas nenit 274 (1) dhe (3) të KPK-së ndërsa lidhur me K.P., kemi veprat penale të shpërdorimit të pozitës zyrtare ose të autorizimit sipas nenit 339 (1) dhe (3) të KPK-së dhe nxjerrjen e vendimeve të kundërligjshme gjyqësore sipas nenit 346 të KPK-së. Përveç kësaj, K. P. dhe L. P. u akuzuan edhe për veprën

penale të falsifikimit të dokumenteve sipas nenit 333 (1), nënpar. 1 të KPK-së, lidhur me nenin 23 të KPK-së. Kjo aktakuzë po ashtu propozonte caktimin e dënimit plotësues për të pandehurit K. P., L. P. dhe I. S.

2. Aktakuza në fjalë u konfirmuar me aktvendimin e gjyqtarit konfirmues nr. KA 304/11, të datës 23 shtator 2011 dhe 27 dhjetor 2011, lidhur me pikën e krimit të organizuar sa u përket veprave penale të Shpërdorimit të pozitës zyrtare ose të autorizimit dhe nxjerrjen e vendimeve të kundërligjshme gjyqësore. Gjyqtari konfirmues ka hedhur poshtë aktakuzën lidhur me pikën e falsifikimit të dokumenteve.

3. Shqyrtimi gjyqësor në lëndën penale është mbajtur në mes të datave 12 mars dhe 24 maj 2012 pranë Gjykatës së Qarkut të Pejës.

4. Më 24 Maj 2012, trupi gjykues mori aktgjykimin nr. P 477/11 me të cilin i akuzuari K. P. ishte shfajësuar për veprën penale të krimit të organizuar por ishte shpallur fajtor për atë të Shpërdorimit të pozitës zyrtare ose të autorizimit sipas nenit 339 (1) dhe (3) të KPK-së. I njëjti është dënuar me burgim prej pesë (5) vjetësh. Aktakuza e cila ka të bëjë me veprën e nxjerrjes së kundërligjshme të vendimeve gjyqësore sipas nenit 346 të KPK-së është refuzuar nga gjykata e shkallës së parë për shkak se gjykata ka konstatuar se kjo veprë penale përfshihet në veprën penale të shpërdorimit të pozitës zyrtare ose të autorizimit sipas nenit 339 (1) dhe (3) të KPK-së. Të pandehurit L. P. dhe B. B. janë shpallur fajtorë për veprën penale të mashtrimit sipas nenit 261 (1) dhe (2) të KPK-së, duke bërë kështu ri-cilësimin e akuzës fillestare të krimit të organizuar. I pandehuri L. P. është dënuar me burgim prej tre vjetësh ndërsa i pandehuri B. B. është dënuar me dënim me kusht prej gjashtë muajsh burgim. Përveç kësaj, është shqiptuar edhe dënimi plotësues i ndalimit të ushtrimit të funksioneve në administratën publike apo i funksioneve të shërbimit publik ndaj të pandehurit K. P si dhe dënimi plotësues i ndalimit të ushtrimit të profesionit, aktivitetit apo detyrës ndaj të pandehurve L. P. dhe B. B. I pandehuri I. S. është liruar nga ana e gjykatës së shkallës së parë.

5. Më 24 maj 2012, Gjykata e Qarkut ka caktuar paraburgimin ndaj të akuzuarit K. P. derisa aktgjykimi të marrë formën e prerë.

6. Mbrojtja dhe PSRK-ja pastaj kanë ushtruar ankesa ndaj aktgjykimit P. 477/11. Shkresat e lëndës më pastaj janë kaluar në Gjykatën Supreme të Kosovës si gjykatë kompetente e shkallës së dytë në atë kohë. Sipas nenit 39, par. (1) të Ligjit mbi gjykatat, ligjit nr. 03/L-199, lënda është kaluar më 1 janar 2013 te Gjykata e Apelit si gjykatë (e re) kompetente.

II. Gjetjet e Gjykatës së Apelit

1. Kompetenca e Gjykatës së Apelit

7. Gjykata e Apelit është gjykatë kompetente për të vendosur rreth ankesës në bazë të nenit 17 dhe 18 të Ligjit mbi gjykatat (Ligji nr. 03/L-199).

8. Kolegji i Gjykatës së Apelit formohet në përputhje me nenin 19 , par. (1) të Ligjit mbi Gjykatat dhe me nenin 3 të Ligjit mbi juridiksionin, përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji nr. 03/L-053).

2. Ligji i zbatueshëm procedural - *mutatis mutandis* Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, i cili ka qenë në fuqi deri më 31.12.2012

9. Ligj i zbatueshëm i procedurës penale për lëndën përkatëse penale është Kodi i Procedurës Penale të Kosovës i cili ka qenë në fuqi deri më datën 31 dhjetor 2012.¹ Interpretimi i drejtë i dispozitave kalimtare të Kodit të Procedurës Penale (KPP), në fuqi që nga data 1 janar 2013, përcakton që në procedurat penale të nisura para hyrjes në fuqi të kodit të ri, për të cilat gjykimi tashmë ka filluar por nuk ka përfunduar me vendim të formës së prerë, të zbatohen dispozitat e KPPK-së *mutatis mutandis* derisa vendimi të marrë formën e prerë. Në këtë aspekt i referohemi mendimit ligjor nr. 56/2013 të Gjykatës Supreme të Kosovës, të miratuar në seancën e saj të përgjithshme të datës 23 janar 2013.

4. Gjetjet mbi meritat

4.1 Pohimet rreth shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale

a. Pohimi rreth shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale për shkak të shqiptimit të dënimit plotësues dhe ri-cilësimit të veprës penale të krimit të organizuar në atë të mashtrimit

10. Mbrojtja e të pandehurit B. B., parashtrohet se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të kodit të procedurës penale sipas nenit 403 (1) nënpar. 10, lidhur me nenin 386 (1) të KPPK-së duke ia shqiptuar dënimin plotësues i cili nuk është propozuar as në aktakuzë as nuk ka qenë propozim i prokurorit në fjalën përmbyllëse. Përveç kësaj, pohohet se ri-cilësimi i veprës penale nga krimi i organizuar, siç ka qenë në aktakuzë, në veprën penale të mashtrimit, përbën një shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

11. Gjykata e Apelit gjen jomeritore pohimin e bërë nga mbrojtja sa i përket shqiptimit të dënimit plotësues dhe të ri-cilësimit të akuzave.

Edhe pse aktakuza nuk propozon shqiptimin e një dënimi plotësues ndaj të pandehurit B. B., gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar dënimin plotësues të ndalimit të ushtrimit të profesionit, aktivitetit apo detyrës. Për më tepër, gjykata e shkallës së parë ka dënuar të pandehurit B. B., dhe L. P., për veprën penale të mashtrimit sipas nenit 261 (1) dhe (2) të KPK-së pas ri-cilësimit të akuzës fillestare të krimit të organizuar sipas nenit 274 (1) dhe (2) të KPK-së. Gjykata e shkallës së parë nuk ka e njoftuar as të pandehurin B. rreth shqiptimit të mundshëm të dënimit plotësues as të pandehurit B.B. dhe L.P. para se t'i dënonte rreth mundësisë së ri-cilësimit të akuzave fillestare të aktakuzës.

¹ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, në fuqi nga data 06.04.2004 deri më datën 31.12.2012.

12. Kolegji i apelit vëren se sipas nenit 386 (2) të KPPK-së, gjykata e shkallës së parë nuk ishte e obliguar nga propozimet e prokurorisë për ta bërë cilësimin juridik të veprës. Prandaj, ri-cilësimi juridik i akuzës fillestare prej krimit të organizuar në mashtrim nuk përbën vetvetiu një shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale pasi që kjo mundësi është e përcaktuar qartë me kodin e procedurës. Megjithatë, në jurisprudencën e Gjykatës Supreme të Kosovës ka qenë praktikë që kur të shkohet me ri-cilësim juridik të veprës sipas nenit 386 të KPPK-së, trupi gjykues duhet patjetër të sigurohet se i akuzuari do të njoftohet me kohë për një ri-cilësim të tillë (shih *Gjykata Supreme e Kosovës, Ap - Kz nr. 61/2012, 02.10.2012, par. 29; shih edhe Gjykata Ndërkombëtare Penale, ICC-01/04-01/07-3319, 17.12.2012, para. 37*). Edhe pse një njoftim i këtillë shprehimisht nuk kërkohet nga dispozitat e KPPK-së, nga parimi për gjykim të drejtë siç përcaktohet me nenin 12 (1) të KPPK-së, nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenin 6 (3) të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut dhe liritë themelore (“KEDNJ”), me të cilin mes tjerash garantohet e drejta e të akuzuarit “për të pasur kohë dhe mundësi të përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes së tyre”. Për më tepër, e drejta për t’u informuar rreth natyrës, shkakut dhe përmbajtjes së akuzave përshin edhe të drejtën e të akuzuarit për t’u informuar rreth karakterizimit juridik të fakteve mbi të cilat fillimisht janë bazuar akuzat. Ky interpretim mbështetet edhe me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“GjEDNJ”), e cila konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, kur karakterizimi juridik i fakteve është ndryshuar pa i ofruar mundësi mbrojtjes për t’i paraqitur vërejtjet e tyre (*GjEDNJ, Pelissier dhe Sassi kundër Francës, kërkesa nr. 25444/94, aktgjykimi, 25.03.199, para. 62; GjEDNJ, Vesque kundër Francës, kërkesa nr. 3774/02, aktgjykimi, 03.07.2001, par. 57 dhe nenet në vazhdim*). Sipas mendimit të kolegjit të apelit, lëshimi i trupit gjykues për t’i njoftuar të pandehurit rreth ri-cilësimit të mundshëm të akuzave është arsye relative e ankesës e cila mund të kundërshtohet nga palët duke u bazuar në nenin 403 (2) nënpar. 2 të KPPK-së dhe jo siç kanë vepruar ankuesit në lëndën në fjalë, duke u bazuar në nenin 403 (1) nënpar. 12 të KPPK-së. Si pasojë e kësaj, ankuesi duhet të përshkruajë shkurtimisht në ankesa mënyrën sipas së cilës shkelja e pohuar e të drejtave të mbrojtjes “ka ndikuar apo ka mundur të ndikojë në nxjerrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë.”

13. Respektimi i së drejtës për gjykim të drejtë duhet patjetër të përcaktohet në frymën e procedurës në tërësi, duke përfshirë këtu procedurën ankimore (*shih GjEDNJ, Sipavicius kundër Lituanisë, kërkesa nr. 49093/99, Aktgjykimi, 21.02.2002, para. 29; GjEDNJ, Dallos kundër Hungarisë, kërkesa nr. 29082/95, Aktgjykimi, 01.03.2001, para. 47 dhe ato në vazhdim*.) Në lëndën në fjalë, ankuesit kanë pasur të drejtë të kontestojnë dënimin lidhur me të gjitha aspektet faktike dhe ligjore para Gjykatës së Apelit, e cila po ashtu ka mbajtur një seancë ankimore në praninë e palëve më datën 25 prill 2013, në të cilën janë rishikuar ankesat e ankuesve rreth ri-cilësimit të akuzave si nga pikëpamja procedurale po ashtu edhe nga ajo substanciale. Prandaj, të pandehurit B. B. dhe L. P. kanë pasur mundësinë e argumentimit të mbrojtjes së tyre përkitazi me akuzat e ri-cilësuar para kolegjit të apelit, i cili sipas nenit 420 të KPPK-së, mes tjerash është kompetent edhe për të anuluar apo ndryshuar aktgjykimin. Për këtë arsye, në pikëpamjen e këtij kolegji të apelit - shkelja procedurale e shkaktuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë duke mos njoftuar të pandehurit B. B. dhe L. P. rreth ri-cilësimit juridik të akuzave - është korrigjuar në fazën ankimore pasi që atëherë ka pasur kohë dhe mundësi të përshtatshme për t’u përgatitur për cilësimin juridik në procedurën ankimore. Prandaj, kjo arsye e ankesës refuzohet si e pabazë.

14. Lidhur me atë se i pandehuri B. B. pretendon shkelje të nenit 386 (1) të KPPK-së kur i ishte shqiptuar dënimi plotësues, i cili nuk kishte qenë i propozuar në aktakuzë, kolegji i apelit gjen se kjo situatë nuk përcaktohet me nenin 386 të KPPK-së. Neni 386 (1) i KPPK-së ka si qëllim të sigurojë të mos tejkalohet akuza duke shkuar përtej gjendjes faktike të veprës së specifikuar në aktakuzë ose duke përfshirë persona të tjerë përveç të pandehurve të përmendur në aktakuzë. Dënimi plotësues mund të shqiptohet së bashku me dënimin kryesor apo atë alternativ, prandaj shqiptimi i një dënimi plotësues nuk ka ndikim në cilësimin juridik të akuzës apo në gjendjen faktike të veprës së përcaktuar në aktakuzë. Dështimi për ta njoftuar të pandehurin B.B. lidhur me shqiptimin e mundshëm të dënimit plotësues nga ana e trupit gjykues nuk përbën as shkelje të garancive minimale të siguruara me të drejtën për gjykim të drejtë. Kjo për shkak se dënimi plotësues është i lidhur me caktimin e dënimit kryesor apo atij alternativ, ashtu siç parashihet sipas nenit 54 (1) të KPK-së. I pandehuri i akuzuar për një vepër penale duhet patjetër ta dijë se ekziston mundësia e përgjithshme e shqiptimit të dënimit plotësues ndaj tij. Prandaj, nuk ka nevojë të njoftohet i pandehuri rreth kësaj mundësie e cila tashmë është e përcaktuar përmes KPK-së.

b. Pohimet për shkelje esenciale të procedurës penale për shkak se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kundërthënës në brendinë e tij ose me arsyet e aktgjykimit (neni 403, para. 12 i KPPK-së)

15. Ankesa e parashtruar nga i pandehuri K. P. pretendon se ka pasur shkelje esenciale të procedurës penale për shkak se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kundërthënës në brendinë e tij ose me arsyet e aktgjykimit. Më saktë, ankesa e parashtruar nga i pandehuri L.P. pretendon se ka mospërputhje në mes të dispozitivit për të pandehurin K.P. dhe për të pandehurin L.P., përkitazi me atë se cili nga këta dy persona ka propozuar zgjidhjen e kontestit në vlerën prej 16.000 eurosh gjatë seancës së Gjykatës Komonale të mbajtur më datën 8 prill 2008.

16. Kolegji i apelit gjen se dispozitivi nuk bie në kundërshtim me arsyetimin e dhënë në aktgjykim. Dispozitivi gjatë përshkrimit të fakteve në përgjithësi është i qartë dhe i kuptueshëm duke mos i dhënë kështu asnjë arsye kolegjit të apelit për të ndryshuar apo për të anuluar aktgjykimin e trupit gjykues.

17. Trupi gjykues vëren se dispozitivi nuk është e domosdoshme të përmbajë të gjitha detajet e ngjarjes kritike. Neni 396 (3) i KPPK-së përcakton përmbajtjen e dispozitivit, duke iu referuar nenit 391 të KPPK-së. Kur të kemi të bëjmë me përshkrimin e veprës penale, ajo çfarë duhet patjetër të përmbajë dispozitivi janë ‘faktet dhe rrethanat me të cilat tregohet natyra kriminale e veprës së kryer nga ana e të akuzuarit si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitave përkatëse të ligjit penal’. Sa i përket rëndësisë të cilën Gjykata e Apelit duhet t’ia japë mospërputhjeve të vogla në mes të dispozitivit dhe pjesës së arsyetimit të aktgjykimit si dhe ndikimit të tyre në vendimet e Gjykatës së Apelit, kolegji gjen se duhet të zbatohet rregulla *de minimis* e cila do të thotë se disa të meta të vogla të dispozitivit nuk e justifikojnë anulimin e aktgjykimit, po qe se pjesët e tjera të aktgjykimit – të shikuara si tërësi – e paraqesin si të qartë vendimin e marrë nga trupi gjykues.

18. Trupi gjykues pajtohet me ankesën e parashtruar nga i pandehuri L. P. se dispozitivi lidhur me të pandehurit K. P. dhe L. P. është kontradiktor lidhur me atë se cili prej tyre propozoi si zgjidhje shumën prej 16.000 eurosh gjatë seancës së Gjykatës Komunale të mbajtur më 8 prill 2008. Dispozitivi lidhur me të pandehurin Puka, në pjesën që ka të bëjë me të, thotë kështu: “[në] emër të Fondit Garantues të Kosovës, I. S. ka propozuar ofertën për zgjidhje në shumën prej 16.000 eurosh”² përderisa dispozitivi lidhur me të pandehurin L.P., thotë: “[më] 8 prill 2008, L. P. ka propozuar zgjidhje në shumën prej 16.000 EUR”.³

19. Trupi gjykues gjen se është e qartë nga pjesa e arsytimit të aktgjykimit se ishte I. S. ai që propozoi ofertën përfundimtare në shumën prej 16.000 EUR gjatë seancës dëgjimore të Gjykatës Komunale të prillit 2008. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë i është referuar procesverbalit të seancës dëgjimore të Gjykatës Komunale, ku shkruan se përfaqësuesi i paditësit ka kërkuar pauzë gjatë seancës gjoja për t’u konsultuar me klientin e vet për ofertën përfundimtare të kompensimit, e cila ishte propozuar nga I. S. në cilësinë e përfaqësuesit të Fondit Garantues të Kosovës.⁴ Gjykata e shkallës së parë po ashtu me të drejtë ka konstatuar se nuk ka qenë Z. M., siç thuhet në procesverbalin e seancës dëgjimore të Gjykatës Komunale, por në të vërtetë L. P. personi i cili përfaqësonte F. G. gjatë seancës dëgjimore. Kështu, dispozitivi lidhur me L. P. është nga aspekti formal kontradiktor me arsytimin e aktgjykimit. Megjithatë, trupi gjykues konstaton se nga pjesa e arsytimit të aktgjykimit është e qartë se kush e ka propozuar ofertën përfundimtare. Sidoqoftë, kolegjin gjen se çështja nuk ka të bëjë me ndonjë fakt vendimtar i cili do të kishte ndikim në epilogun e gjykimit. Më shumë ka të bëjë me një mospërputhje të vogël e cila nuk e justifikon anulimin e aktgjykimit.

4.2 Pohimet se ka pasur shkelje të ligjit penal për shkak se vepra për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor nuk përbën vepër penale (neni 404 (1) i KPPK-së)

20. Ankesa e parashtruar në emër të të pandehurit B.B. pohon se nga provat e prezantuara gjatë gjykimit nuk mund të vërtetohet se i njëjti ka vepruar me dashjen e kërkuar për të nxjerrë përftim të kundërligjshëm material për F. G. Ngjashëm me këtë, edhe të pandehurit L. P. dhe K. P. argumentojnë në ankesat e tyre përkatëse se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të ligjit penal kur ka konstatuar se të njëjtit kishin vepruar me siç përcaktohet *mens rea*.

21. Kolegji i apelit gjen se këto pohime nuk qëndrojnë. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vërtetuar dashjen e të pandehurve.

22. Trupi gjykues vëren se elementi subjektiv, dashja për të kryer vepër penale, është kusht themelor për veprën penale i cili është i domosdoshëm për të konstatuar përgjegjësinë penale të të akzuarit (nenet 11 (1) dhe 15 të KPK-së). Përveç dashjes përfundimtare (*dolus eventualis*) si dhe asaj të drejtpërdrejtë (*dolus directus*), ligji penal përcakton se vepra të caktuara penale kërkojnë edhe dashjen e posaçme (*dolus specialis*). Kur kemi të bëjmë me këtë të fundit, për të shpallur dikë fajtor, gjykata nuk duhet domosdo të vërtetojë se kryerësi kishte dijeni rreth

² Shih Gjykata e Qarkut e Pejës, Aktgjykimi, P. nr. 477/11, i datës 24 Maj 2012, faqe 4 (versioni në gjuhën angleze).

³ Po aty, faqe 5

⁴ Dosja e prokurorisë, pjesa C.

elementeve të veprës penale si dhe vullnet për ta kryer të njëjtën, por po ashtu edhe atë se kishte vepruar me dashjen e dytë siç përcaktohet me veprën penale përkatëse. Të gjitha veprat penale për të cilat janë shpallur fajtorë të pandehurit kanë në vete *dolus specialis*: vepra penale e shpërdorimit të pozitës zyrtare ose autorizimit kërkon nga kryerësi të veprojë me “dashje të nxjerrjes së përfitimit të kundërligjshëm për veten e tij ose të saj apo për ndonjë person tjetër ose organizatë tjetër ose për t’i shkaktuar ndonjë dëm personit apo organizatës tjetër”; vepra penale e mashtrimit kërkon si kusht “dashjen për të nxjerrë përfitim material për veten apo për personin tjetër”.

23. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se i pandehuri K. P. ka vepruar me dashjen e cila kërkohet si kusht. Dispozitivi dhe pjesa e arsytimit të aktgjykimit janë të bazuara dhe nuk lënë hapësirë për të dyshuar në këtë drejtim. Kolegji i apelit po ashtu ka marrë parasysh dashjen e posaçme dhe ka gjetur në mënyrë të pranueshme se i pandehuri K.P. jo vetëm që ka vepruar me dashjen e nxjerrjes së përfitimit material për veten dhe për L. P. por po ashtu për ta dëmtuar Fondin Garantues të Kosovës.⁵

24. Lidhur me të akuzuarin B. B., Gjykata e Apelit vëren shqetësimet e veta për arsytimin e dhënë nga trupi gjykues përkitazi me dashjen e të akuzuarit. Ajo çfarë është posaçërisht shqetësuese është deklarata e trupit gjykues se i akuzuari “*me gjasë ka besuar se F. G. do t’i takonte kompensimi*”.⁶ Siç është përvijuar më lart, vepra penale e mashtrimit kërkon provën e dashjes së posaçme se kryerësi ka vepruar me dashje për të nxjerrë përfitim material për veten apo për ndonjë person tjetër. Po qe se trupi gjykues ka dyshime lidhur me ekzistimin e elementeve subjektive të veprës penale atëherë duhet domosdo ta lirojë të pandehurin në bazë të parimit *in dubio pro reo*. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se B.B. as nuk ka ditur për planin e sajuar nga K.P. dhe L.P. për ta mashtruar Fondin Garantues të Kosovës për përfitime të veta materiale, as nuk ka pranuar më shumë se 200 euro për përgatitjen e raportit mjekësor. Gjykata ka gjetur se i vetmi motiv për të akuzuarin ka qenë “*t’i ekzagjerojë lëndimet gjoja të pësuar nga F. G. duke fryrë kështu sasinë e kërkesës për kompensim, të prezantuar në emër të tij*”.⁷ Kështu, edhe pse gjykata e shkallës së parë është dashur të shtjellojë më saktë parimin *mens rea* të të pandehurit B.B., është pikëpamje e trupit gjykues se del e qartë nga këto gjetje faktike se trupi gjykues ka qenë plotësisht i bindur se i akuzuari ka vepruar me dashjen e posaçme e cila përcaktohet. Kjo gjë shprehet edhe në dispozitivin e aktgjykimit.

25. Po ashtu lidhur me të akuzuarin L.P., gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se të pandehurit kanë vepruar me dashjen e cila kërkohet. Përsëri, elementet subjektive të veprës penale të mashtrimit nuk janë vlerësuar në mënyrë eksplicite dhe të hollësishtme në pjesën e arsytimit të aktgjykimit. Megjithatë, Gjykata e Apelit gjen se në mënyrë të qartë shihet nga disa rrethana faktike siç është vërtetuar nga trupi gjykues se i akuzuari ka vepruar me parimin e përcaktuar *mens rea*. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka refuzuar argumentin e prezantuar nga i akuzuari se i njëjti nuk ka qenë në dijeni rreth planit mashtrues duke iu referuar seancës dëgjimore në Gjykatën Komunale më datën 8 prill 2008, gjatë së cilës ai kishte kërkuar shtyrjen e seancës me qëllim të gjoja marrjes së udhëzimeve prej klientit të vet. Përveç kësaj, trupi gjykues me të drejtë ka vlerësuar deklaratën e të akuzuarit se ai i kishte dhënë K. P. shumën prej 16.000 eurosh si provë kundër L.P.. Vlerësimi i provave të prezantuara është i arsyeshëm dhe i

⁵ Gjykata e Qarkut e Pejës, Aktgjykimi, P. nr. 477/11, i datës 24 Maj 2012, faqe 46 (versioni në gjuhën angleze). Gjykata e Qarkut e Pejës, Aktgjykimi, P. nr. 477/11, i datës 24 Maj 2012, faqe 50 (versioni në gjuhën angleze).

⁷ Gjykata e Qarkut e Pejës, Aktgjykimi, P. nr. 477/11, i datës 24 Maj 2012, faqe 54 (versioni në gjuhën angleze).

njëjti ilustron se trupi gjykues – siç thuhet në mënyrë të qartë në dispozitivin e aktgjykimit – ka qenë i bindur se i akuzuari ka vepruar me elementet subjektive të veprës penale të mashtrimit. Më tej, të qenit në dijeni të të pandehurit se F. G. nuk kishte pësuar lëndimet e pohuara në kërkesën në fjalë, gjithashtu mund të vërtetohet nga deklaratat e dëshmitarit P. J. i cili gjatë dhënies së dëshmisë së vet në gjykatë ka përmendur një takim i cili është mbajtur në mes tij, L.P. dhe F. G., në të cilin F.G. i kishte pohuar të pandehurit L. P. se nuk kishte marrë asnjë lëndim tjetër përveç një gërvishtje të marrë në hundë.⁸

4.3 Vlerësimi sipas detyrës zyrtare i shkeljes së ligjit penale në dëm të të akuzuarit (neni 404, 415, nënpar. 4 i KPPK-së)

26. Gjykata e shkallës së parë ka refuzuar akuzën ndaj K. P. për veprën penale të nxjerrjes së kundërligjshme të vendimeve gjyqësore dhe në vend të saj kishte dënuar të pandehurin për veprën penale të shpërdorimit të pozitës zyrtare ose të autorizimit duke mbajtur pikëpamjen se vepra penale e nxjerrjes së kundërligjshme të vendimeve gjyqësore “konsumohet” nga vepra penale e shpërdorimit të pozitës zyrtare ose autorizimit. Për më tepër, trupi gjykues ishte i mendimit se “*nxjerrja e një vendimi të kundërligjshëm gjyqësor në këtë rast po ashtu përbënte shpërdorim të pozitës zyrtare ose autorizimit. Elementet esenciale të veprës së dytë penale ishin të njëjta me elementet esenciale të veprës së parë. Për këtë arsye, kolegji gjen se do të ishte një proces i padrejtë dhe abuzues të dënohej i pandehuri K. P. për të dyja veprat penale.*”⁹

27. Trupi gjykues gjen se vlerësimi ligjor i ofruar nga gjykata e shkallës së parë përbën shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit. Gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë parasysh teorinë themelore të ligjit penal duke konstatuar se vepra penale e nxjerrjes së vendimeve të kundërligjshme gjyqësore konsumohet me veprën penale të shpërdorimit të pozitës zyrtare ose autorizimit.

28. Çështja në fjalë ka të bëjë me konceptin e *concursum delictorum*, d.m.th teoria që ka të bëjë me bashkimin ose gjykimin e veprave të shumta kundër një të akuzuari lidhur me të njëjtin grup të rrethanave faktike. KPK-ja nuk e paraqet drejtë për së drejti *concursum delictorum* e as nuk parasheh rregulla të caktuara ose teori doktrinë për caktimin e bashkimit të veprave penale por thjesht e pranon ekzistimin e veprave penale dhe rregullon ndëshkimin e tyre me nenin 71. Duke iu referuar parimeve të përgjithshme të ligjit të përbashkët për të gjitha sistemet kyçe ligjore vendore, gjykatat penale ndërkombëtare konsiderojnë se aty ku zhvillimet e njëjta faktik plotësojnë përcaktimet e veprave të shumta statusore, gjykata mund të jap dënime unike lidhur me këto vepra penale vetëm atëherë kur krimet konsiderohen të ndara mjaftueshëm ose posedojnë ‘një element qenësisht të ndarë’ që nuk është gjetur në tjetrin. Në rast se secili nga dy krimet nuk përmbajnë elemente qenësisht të ndara, krimi me elementin qenësisht të ndryshëm si krim më specifik përfshin tjetrin dhe jepet vetëm një dënim. Ky përcaktim përfshin elementet ligjore krahasuese të dispozitave statusore relevante; faktet specifike të lëndës nuk luajnë ndonjë

⁸ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, P. nr. 477/11, i datës 4 prill 2012, faqe 6 (versioni në gjuhën angleze).

⁹ Gjykata e Qarkut e Pejës, Aktgjykimi, P. nr. 477/11, i datës 24 Maj 2012, faqe 2 dhe 54 (versioni në gjuhën angleze).

rol. (shih *Tribunali Penal Ndërkombëtarë për ish Jugosllavinë, prokurori v. Delalic, Mucic, Delic dhe Landžo ("Celebici")*, IT-96-21-A, "Aktgjykimi", Dhoma e Apelit, 20 shkurt 2001, para. 412-413; *Dhomat e jashtëzakonshme në Gjykatën e Kamboxhias, prokurori v. Kaing Gung Eva (Dutch)*, Nr. i lëndës 001/18-07-2007-DhJGjC/GjS, Aktgjykimi mbi ankesat, 3 shkurt 2012, para. 285 e tutje.; *Gjykata Speciale për Sierra Leone, Prokurori v. Sesay et al., Numri i lëndës SCSL-04-15-A, aktgjykimi mbi ankesat, 26 tetor 2010, para 1190*). Kolegji i apelit respekton këtë qasje ligjore.

29. Sipas mendimit të kolegjit të apelit, i kundërt me gjetjet e gjykatës së shkallës së parë, krahasimi i elementeve ligjore të veprave penale të Shpërdorim i pozitës zyrtar apo autorizimit dhe Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore qojnë në konkluzionin se ky i fundit është krim më specifik që përfshin veprën penale të Shpërdorim i pozitës zyrtar apo autorizimit me zbatimin e parimit *lex specialis derogate lex generali* (shih *tanimë Gjykata e Apelit, PN 240/2013, Aktvendimi mbi ankesën, 17 prill 2013, para. 58*). Kapitulli XXIX i KPK-së përmban "veprat penale kundër detyrave zyrtare" në mesin e të cilave janë veprat penale të diskutuara. Për të dy veprat penale, vlera e mbrojtur është e njëjtë gjegjësisht besimi në administratën e shërbimeve publik. Më tej vepra penale e Shpërdorim i pozitës zyrtar apo autorizimit nuk përmban një element materialisht të ndryshëm e që nuk gjendet në veprën penale të Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore. Edhe pse të dy veprat penale përfshijnë të njëjtat elemente materiale, d.m.th keqpërdorimin e pozitës zyrtare, Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore, mund të kryhet vetëm nga gjyqtarët përmes një akti të caktuar. Prandaj, kjo e fundit kërkon një element qenësisht të ndryshëm i cili kërkon argumentin e një fakti që nuk kërkohet me veprën penale të Shpërdorim i pozitës zyrtar apo autorizimit. Prandaj gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të ligjit penal duke nxjerrë konkluzionin se vepra penale e Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore, është e përfshirë në veprën penale të Shpërdorim i pozitës zyrtar apo autorizimit.

30. Ky keq aplikim i ligjit penal nga trupi gjykues është në dëm të të akuzuarit sepse ka mundur të ketë ndikim në caktimin e dënimit pasi që të dy dispozitat penale parashohin dënime të ndryshme: për veprën penale të Shpërdorim i pozitës zyrtar apo autorizimit parashihet dënimi prej një deri në tetë vjet burgim vjet ndërsa për veprën penale të Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore, parashihet dënimi prej gjashtë muaj deri në pesë vjet burgim.

31. Për këto arsye kolegji i apelit modifikon aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe të akuzuarin K. P. e shpall fajtor për veprën penale të Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore.

32. Kolegji i apelit vë në pah hyrjen në fuqi të kodit të ri penale (Kodi nr. 04/L-082) më 01.01.2013 por në lëndën në fjalë ligji në fjalë nuk është më i favorshëm për të pandehurin.

33. Kolegji i apelit pranon se, në përgjithësi, gjykata jo doemos duhet të sqarojë vendimin e saj lidhur me atë pse e konsideron ligjin e ri më pak të favorshëm. Vetëm po që se gjykata zbaton ligjin e ri si më të favorshëm, rrethanat relevante për vlerësim duhet të sqarohen në pjesën e arsyetimit të vendimit. Në vazhdim, megjithatë, kolegji i apelit do të sqarojë qasjen e përgjithshme të cilën e gjen të zbatueshme në çështjen e konflikteve temporale të ligjit.

33. Kolegji i apelit rithekson se vlerësimi i zbatueshmërisë së ligjeve të njëpasnjëshme penale drejtohet nga parimet e *tempus regit actum* dhe *lex mitior*, të caktuara me nenin 3 të KPK-së (i ri) dhe nenin 33 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Nga dispozitat ligjore të referuara rrjedh se, në parim, ndaj kryerësit duhet të zbatohet ligji i cili ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale (*tempus regit actum*). Megjithatë zbatimi retroaktivë i ligjit penal dhe zanafilla nga parimi i paraparë me nenin 3 (1) të KPK-së (të ri) është i mundshëm në interes të të pandehurit në lëndë në rast se ligji është ndryshuar me kryerjen e veprës në mënyrë që të jetë më i favorshëm për kryerësin (*lex mitior*). Të dy parimet janë themelet e drejtësisë penale dhe ligjit ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut. (shih *GjEDNj, Scoppola v. Itali (nr.2), Kërk. Nr. 10249/03, Aktgjykimi, Dhoma e Madhe, 17.09.2009; GjEDNj, Maktouf dhe Damakanovic v. Bosnje dhe Hercegovinë, Kërk. Nr. 2312/08 dhe 24179/08, Aktgjykimi, Dhoma e madhe, 18.07.2013, Mendimi miratuese i gjyqtarit Pinto de Albuquerque, i shoqëruar nga gjyqtari Vucinic*).

34. Çështja e zbatimit të *lex mitior*, d.m.th caktimi i ligjit më të favorshëm për të pandehurin, duhet të adresohet vetëm “në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë në lëndën në fjalë,”. Në praktikën gjyqësore kjo në përgjithësi pranohet dhe mbështetet me formulimin e qartë të nenit 3 (2) të KPK-së (të ri) (“vendimi i formës së prerë”) se rregulla për zbatimin e ligjit më të butë vlen edhe për procedurën nën mjetet e rregullta juridike e në veçanti në procedurën e apelit ku është vlerësuar ligjshmëria e vendimit të gjykatës së shkallës së parë. (shih *L. Lazarevic, Komentimi i Kodit penal të ish RJ, 1999, neni 4, para 3*). Pasi që në lëndën në fjalë Kodi (i ri) penal (Kodi nr. 04/L-082) hyri në fuqi më 01.01.2013, koha kur aktgjykimi P 477/11 i datës 24.05.20012 nuk ka marrë formën e prerë për shkak të ankesave të paraqitura (neni 398 i KPPK-së), kolegji i apelit duhet të vlerësoj se cili nga dy kodet penale është më i favorshëm për të pandehurin.

35. Në përgjithësi ky përcaktim nuk mund të vendoset *in abstracto* me një krahasim objektiv të ligjeve në fjalë. Duke krahasuar ligjet në fuqi në lëndën e caktuar dhe në lidhje me kryerësin, gjykata medoemos do të vlerësoj *in concreto* se cili ligj është më i favorshëm për të pandehurin përkatës. Veçan nga situata ku ligji i ri lejon diçka që sipas ligjit të vjetër ishte vepër penale, vlerësimi për ligjin më të favorshëm zakonisht është i ndërlikuar dhe kërkon nga gjykata të vërtetoj të gjitha rrethanat kryesisht lidhur me dispozitat mbi dënimin dhe kufizimin ose zvogëlimin e dënimit, masat e paralajmërimit, dënimet e mundshme plotësuese, masat e reja të cilat zëvendësojnë dënimin, masat e sigurisë, pasojat ligjore të dënimit si edhe dispozitat lidhur me ndjekjen penale nëse ajo është kushtëzuar me aprovim. (shih *Gjykata e Bosnjës dhe Hercegovinës, Kolegji i apelit, Lënda kundër Stupar et al., Aktgjykimi, 09.09.2009, para. 497; Dannecker, Leipziger Kommentar zum StGB, 2007, Neni 2, para. 106; L. Lazarevic, supra*).

36. Më tej, është shoshitur praktika gjyqësore se gjykata duhet të zbatoj një ligj në tërësi dhe se nuk mund të kombinoj dy ligje të ndryshme (parimi i “alternativat e rrepta të ligjit” ose “metoda globale e krahasimit”). Prandaj nuk është e mundur të zbatohen vetëm pjesërisht dispozitat nga njëri dhe ligji tjetër në fjalë. Kjo nuk është vetëm për atë se gjykata nuk mund të zbatoj një ligj të kombinuar i cili nuk ekziston por edhe për shkak se çdo regjim ndëshkues ka logjikën e vet dhe gjyqtari nuk mund ta përmbys atë logjik duke përzier ligje të ndryshme të njëpasnjëshme penale. (shih *L. Lazarevic, supra; Komentimi i Kodit penal të B e H, Këshilli i Evropës /Komisioni Evropian, 2005, f. 67; Gjykata Supreme Federale e Gjermanisë, BGHSt 20, 22; GjEDNj,*

Maktouf dhe Damakanovic v. Bosnja e Hercegovina, supra, Mendimi miratues i gjyqtarit Pinto de Albuquerque, p. 45).

37. Lidhur me të pandehurin K.P., kolegji i apelit konsideron se KPK-ja i ri është më i favorshëm për të pandehurin. Dënimi i paraparë për veprën penale të Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore sipas dy kodeve është i njëjtë pasi që të dy dispozitat janë krejtësisht identike. Megjithatë dënimi plotësues i ndalimit të ushtrimit të funksioneve në administratën publik ose në shërbimin publik, sikurse është shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë, është i detyrueshëm sipas KPK-së të vjetër vetëm me dënim “*burgimi prej së paku dhjetë vjet*” (neni 56 (1) i KPK-së) dhe është zgjedhje e trupit gjykues në rast të dënimit me “*burgim deri në dhjetë vjet*” (Neni 56 (2) i KPK-së). Duke pasur parasysh faktin se neni 56 i KPK-së së vjetër në mënyrë të qartë është më i favorshëm për të pandehurin sesa dispozita paralele e nenit 65 të KPK-së së ri – ku shqiptimi i dënimit plotësues është tanimë i detyrueshëm nëse i pandehuri është dënuar me burgim - kolegji i apelit sipas rrethanave të caktuara e konsideron KPK-në e vjetër *lex mitior*.

4.4 Pretendimet për vërtetim të gabuar dhe/ose jo të plotë të gjendjes faktike (neni 405 i KPPK-së)

38. Mbrojtja dhe prokuroria pretendojnë se gjykata e shkallës së parë gabimisht dhe/ose në mënyrë jo të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike.

I akuzuari K. P. pohon se

- Deklarata të cilën i akuzuari B.B. e dha në gjykatë lidhur me domosdoshmërinë e ekzaminimit fizik të F. G. nuk është marrë parasysh sipas rregullit nga trupi gjykues;
- Dëshmia e dëshmitarit F. G. lidhur me të akuzuarin K.P. nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë nga trupi gjykues;
- Trupi gjykues gabimisht e vlerësoi deklaratën e dëshmitarit dr. J. lidhur me bisedën të cilën ai e bëri me të akuzuarin K.P.

I akuzuari B.B. argumenton se trupi gjykues gabimisht vërtetoi faktin se ai në mënyrë të jashtëzakonshme i ekzagjeroj lëndimet trupore të F. G..

I akuzuari L.P. pretendon se trupi gjykues gaboi kur vërtetoi se lirimi me epikrizë ishte i falsifikuar.

E mbështetur me parashtresën e prokurorit të apelit, PSRK-ja paraqet se gjykata e shkallës së parë liroi të pandehurin I. S. mbi bazën e gjetjeve faktike të gabuara dhe jo të plota. Në mënyrë të veçantë u argumentua se gjatë gjykimit është vërtetuar mjaftueshëm se i pandehuri I.S. ka kryer veprën penale të Shpërdorim i pozitës zyrtar apo autorizimit e cila inter alia mund të nxirret nga rrethana faktike se i pandehuri nuk ka bërë një përfaqësim të duhur dhe kualitative të Fondit Garantues të Kosovës.

39. Para se të vlerësoj meritat e argumenteve të paraqitura nga palët, kolegji i apelit e konsideron të nevojshme të qartësoj standardin e shqyrtimit për ankesat lidhur me gjendjen faktike të bërë

nga trupi gjykues. Neni 405 i KPPK-së përcakton termin “vërtetim i gabuar i gjendjes faktike” dhe “vërtetim jo i plotë i gjendjes faktike”. Nga këto përkufizime është e qartë se për ankuesin nuk është e mjaftueshme të demonstrojë vetëm një gabim të supozuar të faktit ose vërtetim jo të plotë të faktit nga trupi gjykues, por më tepër, pasi që kodi i procedurës penale kërkon që vërtetimi i gabuar ose jo i plotë i gjendjes faktike të ndërlidhet me ‘faktin vendimtar’, ankuesi doemos duhet të vërtetojë se vërtetimi i gabuar ose jo i plotë i gjendjes faktike në fakt ndërlidhet me faktin vendimtar d.m.th. është kritik për aktgjykimin e nxjerrë.¹⁰ Rrjedhimisht, vetëm në instanca të tilla, kolegji i apelit do të ndryshojë vendimin e trupit gjykues.

40. Është parim i përgjithshëm i procedurës së apelit që Gjykata e Apelit doemos duhet të jap një masë të vlerësimit në gjetjen e faktit të arritur nga trupi gjykues sepse trupi gjykues është ai i cili më së miri është i dedikuar të vlerësoj provat. Gjykata Supreme e Kosovës shpesh konsideroi se duhet “*të pajtohet me vlerësimin e trupit gjykues për besueshmërinë e dëshmitarëve gjyqësorë që u paraqitën personalisht para tyre dhe të cilët dëshmuuan personalisht para tyre. Nuk është e duhur për Gjykatën Supreme të Kosovës të mos pranoj vlerësimin e trupit gjykues për besueshmërinë e atyre dëshmitarëve përveç nëse ka baza të forta për ta bërë atë.*” Standardi të cilën Gjykata Supreme e zbatoi ishte “*Nuk do të duhej të pengoj gjetjet e trupit gjykues, përveç nëse provat në të cilat është mbështetur trupi gjykues nuk kanë mundur të pranohen nga çfarëdo gjykatë e arsyeshme e faktit, ose kur vlerësimi i tij ka qenë ‘tërësisht i gabueshëm’* (Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZi 84/2009, 3 dhjetor 2009, para. 35; Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZi 2/2012, 24 shtator 2012, para. 30). Qasja e ndërmarrë nga Gjykata Supreme reflekton parimin e procedurës së apelit i cili është zbatuar – megjithëse me disa ndryshime – edhe në ligjin e përbashkët por edhe në juridiksionin e ligjit civil e njëherazi edhe në procedurën ligjore penale ndërkombëtare. (shih p.sh Gjykata Supreme e Irlandës, *Hay v. O’Grady*, [1992] IR 210; Gjykata Federale e Drejtësisë, Gjermani, BGHSt10, 208 (210); Tribunali penal ndërkombëtar për ish Jugosllavinë, *Prokurori v. Kupreskić et al.*, IT-95-16-A, Aktgjykimi mbi ankesat, para. 28 e më tej.).

41. Në lidhje me ankesën e ushtruar nga i pandehuri K. P., kolegji i apelit konsideron se trupi gjykues ka vërtetuar drejt dhe plotësisht gjendjen faktike mbi bazën e analizës së kujdesshme të provave. Trupi gjykues konsideroi provat ndaras dhe bashkërisht dhe vlerësoi tërësisht mospërputhjet në prova. Lidhur me çështjen e parë të ngritur nga ankuesi, trupi gjykues gjeti se ishte K. P. ai i cili i tha B. B. se nuk ishte e nevojshme për të që të ekzaminonte F. G.. Ky vërtetim i faktit u bazua në deklaratën e dhënë nga i akuzuari B.B. gjatë marrjes së tij në pyetje nga prokurori më 24 janar 2011.¹¹ Në kundërshtim me paraqitjen e ankuesit, trupi gjykues mori parasysh deklaratën e të akuzuarit B.B. të dhënë në gjykim ku ai deklaroi se ishte i akuzuari L.P. ai i cili tha se nuk ishte e nevojshme për të bërë ekzaminim fizik të F. G.. Megjithatë trupi gjykues ishte thjesht i bindur për vërtetësinë e kësaj deklarate dhe nxori konkluzionin se ishte deklarata e dhënë në prokurori ajo që ishte e “qartë dhe pa ekuivokë”. Kolegji i apelit nuk është në pozicion për të ndërhyrë në këtë vlerësim të trupit gjykues sepse nuk është as tërësisht i gabuar e as i papranueshëm me çfarëdo gjykimi të arsyeshëm të faktit. Përkundrazi konkluzioni u bazua në arsyetim të shëndosh se “*provat e dhëna në prokurori janë dhënë më shumë se një vit*

¹⁰ Shih edhe B. Petric, në: Komete të neneve të Ligjit të procedurës penale të Jugosllavisë, Botimi i 2të 1986, neni 366, para. 3.

¹¹ Dosja e Prokurorisë, tab G, f. 4.

para dëshmisë së tij në gjykatë".¹² Në secilin rast, ankuesi në ankesën e tij nuk ka treguar se si ky vërtetimi i supozuar i gabuar i faktit mund të ndërlidhet me faktin vendimtar kritik për aktgjykimin e nxjerrë.

42. I pandehuri K.P. më tej vë në pah në ankesën e tij se trupi gjykues gabimisht vlerësoi dëshminë e dëshmitarit F. G në lidhje me të. Ai në veçanti pohon se, në kundërshtim me gjetjet faktike të trupi gjykues, ai asnjëherë nuk e ka marrë shumën e supozuar prej 16.000 EUR, e cila, sipas mendimit të tij, konfirmohet edhe nga deklaratat e të akuzuarit L.P. Kolegji i apelit e konsideron këtë pohim pa meritë. Trupi gjykues e ka arsyetuar mirë vlerësimin e tij të provave duke përfshirë besueshmërinë e deklaratës së dëshmitarit F.G. e cila në gjerësi është diskutuar në pjesën e arsyetimit të aktgjyimit. Për vërtetimin e faktit se i akuzuari K.P. më 25 prill 2008 pranoi shumën prej 16.000 EUR para të gatshme nga L. P., trupi gjykues jo vetëm që i ka adresuar në mënyrë korrekte kundërtëhëniet në deklaratën e dhënë nga ky dëshmitar lidhur me çështjen nëse i akuzuari K.P. në të vërtetë mori parat¹³, por vlerësoi drejt edhe deklaratën e F. G. të dhënë në polici më 18 gusht 2008¹⁴, dëshminë e të akuzuarit L.P. para trupit gjykues¹⁵ si edhe provat dokumentare lidhur me transferimin e parave¹⁶.

43. Kolegji i apelit më tej refuzon parashtrësën e ankuesit se trupi gjykues gabimisht vlerësoi deklaratën e dëshmitarit Dr. J., lidhur me bisedën telefonike të cilën ai e pati me të pandehurin K.P. lidhur me nënshkrimin për lëshimin e raportit të epikrizës. Edhe pse është e vërtetë se dëshmitari gjatë dëshmisë së tij dhënë prokurorit deklaroi se K.P. i ka thënë atij se nuk duhet të brengoset nëse nuk është nënshkrimi i tij pasi që çështja do të verifikohet nga një ekspert, në kundërshtim me parashtrësën e ankuesit, dëshmitari në realitete gjatë dëshmisë së tij në gjykatë deklaroi se K.P. i ka thënë atij *"ky nuk është nënshkrimi yt doktor"*.¹⁷ Përveç kësaj, pasi u ballafaqua me këtë mospërputhje të mundshme, dëshmitari deklaroi se ai qëndron prapa deklaratës së tij të dhënë në gjykatë. Kështu kolegji i apelit nuk sheh se si trupi gjykues ka mundur të gaboj duke ndjekur këtë dëshmitar dhe duke dhënë konkluzionin se nga dëshmia e tij në gjykatë është e qartë se ai besonte që K.P. e dinte se nuk ishte nënshkrimi i tij.¹⁸

44. Në ankesën e tij, i akuzuari B.B. paraqet se gjetjet e trupit gjykues se i pandehuri në raportin e tij mjekësor ka *"ekzagjeruar me dashje dhe plotësisht lëndimet"* që ai besonte se i mori F. G., është konkluzion supozues dhe paragjykues jo i bazuar në ndonjë provë materiale të sjellë gjatë shqyrtimit gjyqësor. Pas vlerësimit të provave relevante e edhe arsyetimit të trupit gjykues, kolegji i apelit e refuzon si të pabazuar këtë arsye të ankesës. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë nxori konkluzionin se raporti mjekësor i shkruar nga i pandehuri B.B. përmbante shumë paraqitje të falsifikuara lidhur me llojin dhe shkallën e plagëve gjoja të pësuar nga F. G..¹⁹ Fakti se F. G. nuk ka pësuar lëndime të cilat janë referuar në raportin mjekësor të përpiluar nga i

¹² Gjykata e Qarkut në Pejë, Aktgjykimi, P. nr. 477/11, i datës 24 maj 2012, f. 27 (versioni në gjuhën angleze).

¹³ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, P 477/11, 23 mars 2012, f. 9 dhe 14; Gjykata e Qarkut në Pejë, Aktgjykimi, P. nr. 477/11, i datës 24 maj 2012, f. 40 (versioni në gjuhën angleze)

¹⁴ Gjykata e Qarkut në Pejë, Aktgjykimi P. nr. 477/11, i datës 24 maj 2012, f. 39 (versioni në gjuhën angleze)

¹⁵ Gjykata e Qarkut në Pejë, Aktgjykimi P. nr. 477/11, i datës 24 maj 2012, f. 25, 45 (versioni në gjuhën angleze).

¹⁶ Dosja e Prokurorisë, tab C.

¹⁷ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, P. nr. 477/11, 3 prill 2012, f. 4 (versioni në gjuhën angleze).

¹⁸ Gjykata e Qarkut në Pejë, Aktgjykimi P. nr. 477/11, i datës 24 maj 2012, f. 18, 22, 36, 44 (versioni në gjuhën angleze).

¹⁹ Gjykata e Qarkut në Pejë, Aktgjykimi P. nr. 477/11, i datës 24 maj 2012, f. 49, 50 (versioni në gjuhën angleze).

pandehuri B.B. mund të nxirret nga dëshmia e F. G.. Parashtresa e ankuesit e cila përmbante se raporti i tij mjekësor u bazua plotësisht në lëshimin e raportit të epikrizës nuk mund të ndiqet. Trupi gjykues në mënyrë korrekte gjeti se askund në lëshim me raportin e epikrizës nuk është bërë ndonjë referim për frikë të intensitetit të lartë nga F. G., zvogëlim të aftësive të tij fizike prej 25-30%, pesim të përhershëm të ndonjë deformimi trupor, ose paaftësim 100% për 12 muajt e parë lidhur me të gjitha detyrat dhe përgjegjësit. Kolegji i apelit plotësisht mbështet gjetjen e trupit gjykues se këto konkluzione ishin “trillim i pastër”. Gjithashtu trupi gjykues me të drejtë gjeti se këto konkluzione në asnjë mënyrë nuk mund të bazohen në njohurin dhe përvojën e të pandehurit të fituar gjatë shumë viteve duke u marrë me lëndë të shumta të ngjashme. Prandaj kolegji i apelit nuk sheh asnjë arsye për të ndërhyrë në këto vërtetime faktike të trupit gjykues.

45. Kolegji i apelit e konsideron të pa meritë edhe parashtresën e ankuesit se trupi gjykues gaboi kur vërtetoi se lëshimi me formën e epikrizës ishte i falsifikuar. Fakti se fletë lëshimi ishte i falsifikuar në mënyrë të qartë mund të nxirret nga deklaratat e dhënë prej dëshmitarit Dr. J. në gjykatë si edhe Raporti i Ekspertizës përgatitur nga N. I.²⁰ Trupi gjykues me të drejtë mori parasysh këtë provë.²¹

46. Lidhur me ankesën e paraqitur nga PSRK-ja, Gjykata e Apelit pajtohet me parashtresën dhe argumentin e paraqitur nga prokuroria dhe gjen se lirimi i të pandehurit I. S. u bazua në vërtetime të gabuara dhe jo të plota nga gjykata e shkallës së parë prandaj e kthen lëndën në Gjykatën Themelore në Pejë në rigjykim sa i përket këtij të pandehuri.

47. Trupi gjykues vendosi të liroj të pandehurin I.S sepse nuk ka mundur të gjej prova të mjaftueshme se ai ishte pjesë e skemës së mashtrimit të Fondit Garantues të Kosovës. Ky konkluzion u nxor nga dëshmia e të pandehurit se ai plotësisht u mbështet në raportin mjekësor të B. B. dhe raportin e A. B., nga fakti se i pandehuri ka mundur të besoj se lëshimi i raportit të epikrizës ishte i sigurtë dhe perceptimi i mundshëm i të pandehurit se rregullimi për kompensim në shumën prej 16.000 EUR ishte rezultat i mirë në kuadër të ndarjes së mëhershme të ujdishur të dëmeve.

48. Kolegji i apelit vë në pah se pjesa e arsyetimit të aktgjykimit ngrit edhe disa argumente për përfshirjen e të pandehurit në skemën e krimit por nuk specifikon në hollësi provat të cilat i ka pranuar dhe ato të cilat i ka refuzuar në arritjen e vërtetimit të saj në këtë çështje të caktuar. P.sh. trupi gjykues ka gjetur se fakti që procedura është ndërmarrë vetëm kundër Fondit Garantues të Kosovës mund të sugjeroj se I. S. ishte pjesë e ndonjë mashtrimi.²² Trupi gjykues përmbledh edhe gjetjet e tjera faktike në lidhje me të pandehurin I.S. por as nuk sjell një vlerësim të këtyre e as nuk i vlerëson ato në kontest të përgjithshëm të gjetjeve të saj.

49. Kolegji i apelit pajtohet me parashtresën e PSRK-së se trupi gjykues nuk ka adresuar dhe vlerësuar në mënyrë adekuate dështimet dhe lëshimet e të pandehurit I.S. gjatë procedurës së

²⁰ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, P. nr. 477/11, 3 prill 2012, f. 3 (versioni në gjuhën angleze); Drejtoria e Laboratorit të Mjekësisë ligjore – Prishtinë, Njësia për Analizën e dokumenteve, fotografive dhe zërit, Raporti i Ekspertizës, 5 prill 2011.

²¹ Gjykata e Qarkut në Pejë, Aktgjykimi P. nr. 477/11, i datës 24 maj 2012, p. 35 (versioni në gjuhën angleze)

²² Gjykata e Qarkut në Pejë, Aktgjykimi, P. nr. 477/11, i datës 24 maj 2012, f. 32, 51 (version në gjuhën angleze).

Gjykatës Komunale. Është me rëndësi të konsiderohet deklarata e të pandehurit se ai kishte përvojë të gjatë të punës në përfaqësimin e Fondit Garantues të Kosovës në gjykatat e Kosovës.

50. Trupi gjykues në veçanti është dashur të kërkoj sqarime për çështjet në vijim:

- Pse i pandehuri I.S. nuk ka kërkuar pushim për të iu bashkuar Kompanisë së Sigurimit Sigma në procedurën në Gjykatën Komunale posaçërisht në kuadër të faktit se ai dinte për vendimin e Komisionet për Trajtimin e Dëmeve i cili ndau dëmet në bazën 60/40 në mes të Fondit Garantues të Kosovës dhe Sigurimit Sigma?
- Pse i pandehuri I.S. nuk kërkoj raportin mjekësor të B. B. dhe raportin e A. B. megjithëse ai ishte në posedim të lëshimit me raportin e epikrizës si edhe raportin e policisë të cilët që të dy nuk përmendnin llojin dhe shkallën e lëndimeve të përfshira raportin mjekësor të B. B.?
- Pse i pandehuri I.S. nuk kërkoj praninë e palës së dëmtuar F. G. gjatë seancës dëgjimore në Gjykatën Komunale?

51. Në kuadër të këtyre rrethanave, kolegji i apelit nxjerr konkluzionin se trupi gjykues duhet të adresojë këto pyetje gjatë rigjykitimit dhe ri-trajtojë gjetjet e mëhershme lidhur me të pandehurin I.S.

4.5 Pretendimi për caktim jo të drejtë të dënimit (neni 406 paragrafi 1 të KPPK-së) dhe caktimi i ri i dënimit nga kolegji i apelit lidhur me të pandehurin K. P.

52. Ankesa e ushtruar në emër të të pandehurit L. P. përmban se trupi gjykues shqiptoi një dënim të ashpër, ligjërish të paqëndrueshëm prandaj Gjykata e Apelit duhet të modifikoj vendimin. Edhe ankesa e ushtruar nga i pandehuri K. P. përmban se trupi gjykues veproi në ekstrem kur shqiptoi një dënim jashtëzakonisht të ashpër kundër tij, në veçanti si rezultat i matjes jo korrekt të rrethanave lehtësuese dhe rënduese.

53. KPPK-ja në fuqi i jep të drejtën kolegjit të apelit të shqyrtoj caktimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë. Megjithatë kolegji i apelit e pranon se caktimi i dënimit është objektiv i parë dhe kryesor i trupit gjykues i cili në përgjithësi duhet të respektohet nga kolegji i apelit. Gjyqtarët e trupit gjykues kanë lirinë e gjerë të veprimit në caktimin e dënimit të duhur për shkak të obligimit të tyre për të individualizuar dënimet që të përshtaten me rrethanat e të akuzuarve dhe peshën e krimit. Fushëveprimi i shqyrtimit për Gjykatën e Apelit është prandaj i kufizuar dhe për këtë arsye ky kolegji i apelit është i mendimit se ai duhet të ndërhyjë në gjetjet e trupit gjykues vetëm në rast se trupi gjykues tejkalon autoritetin e tij në marrjen e vendimit mbi dënimin sipas ligjit (neni 404 paragrafi 5 i KPPK-së), nuk cakton dënimin në mënyrë korrekte (neni 406 paragrafi 1 i KPPK-së) ose shqipton një dënim i cili në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet i drejtë; kjo e fundit ndodh nëse dënimin, në kuadër të gamës së mundshme të dënimeve në dispozicion, është në mënyrë të paarsyetuar i lartë ose i ulët.

54. Kolegji i apelit e konsideron dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit L. P. të drejtë dhe të arsyeshëm në kuadër të tërësisë së rrethanave. Trupi gjykues në mënyrë korrekte vlerësoi

rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe nxori një vendim proporcional i cili nuk është as i tepruar e as jashtë shtrirjes së nivelit të arsyeshëm të dënimit.

55. Edhe pse kolegji i apelit do të duhet të nxjerr një vendim mbi dënimin kundër K. P. për shkak të shkëljes së ligjit penal nga trupi gjykues tanimë të përshkruar më lart nën 4.3, prapë se prapë e konsideron të nevojshëm të përgjigjet në ankesën e ushtruar nga i pandehuri K.P. në lidhje me caktimin e dënimit me qëllim që të qartësoj këtë çështje të ligjit.

56. Trupi gjykues *inter alia* mori parasysh këto rrethana rënduese kur përcaktoi dënimin për të akuzuarin K.P.: (1) se i akuzuari ishte gjyqtar dhe si i tillë person zyrtar dhe shërbyes civil i cili mbante pozitë të besueshme; i akuzuari keqpërdori pozitën e tij për përfitim të tij material; (2) i akuzuari nuk shfaqti keqardhje.

57. Kolegji i apelit pajtohet me parashtresën e të pandehurit K.P. se dënimi i shqiptuar kundër tij nga ana e trupit gjykues u bazua në rrethana të cilat u interpretuan gabimisht nga gjykata si rënduese.

58. Fakti se i pandehuri ishte person zyrtar që bëri keqpërdorim të pozitës së tij për përfitim personal nuk mund të merret parasysh për caktimin e dënimit në lëndën aktuale. Këto rrethana janë tashmë elemente të veprës penale për të cilën i pandehuri u shpall fajtor. Prandaj këto rrethana përmbysen kur është në pyetje caktimi i dënimit sepse elementet e krimit tanimë janë reflektuar në shtrirjen e dënimit të veprës penale. Është rregull e përgjithshme dhe pasojë ligjore e parimit *ne bis in idem* ose gjykimit të dyfishtë, që rrethanat të cilat përbëjnë elementet e veprës penale për të cilën i akuzuari u shpall fajtor nuk mund të konsiderohen shtesë edhe për caktimin e dënimit në fazën e dënimit. Trupi gjykues në mënyrë të palejueshme ka llogaritur dyfish të njëjtat rrethana.

59. Gjithashtu trupi gjykues gabimisht vlerësoi si rrethanë rënduese faktin se i pandehuri nuk shfaqti keqardhje. Keqardhja në përgjithësi pranohet si faktor lehtësuese nëse keqardhja e shfaqur është e vërtetë dhe e sinqertë. Megjithatë mungesa e keqardhjes nuk është rrethanë e cila mund të konsiderohet në vet vete rënduese por mund të bëjë relativizmin e efektit lehtësuese të pranimit të fajit. Nga parimi *nemo tenetur se ipsum accusare* del se as refuzimi i të akuzuarit që të bashkëpunoj në mënyrë aktive me autoritetet shtetërore gjatë hetimeve penale e as mënyra në të cilën i pandehuri e zhvillon mbrojtjen e tij, nuk mund të konsiderohen si rrethanë rënduese. Mbetet në të akuzuarin të vendos për strategjinë e tij të mbrojtjes si edhe nëse dhe si ai dëshiron të ushtrojë të drejtën e tij të mbrojtjes. Nëse i akuzuari, sikurse në lëndën në fjalë, vendos të kontestojë tërësisht akuzat ai edhe do të refuzojë të shfaq keqardhje. Prandaj të konsideruarit e kësaj të fundit si një rrethanë rënduese do të ishte ndërhyrje në të drejtën themelore të të akuzuarit për tu mbrojtur.

60. Kolegji tani do të kthehet në caktimin e dënimit kundër të akuzuarit K. P. për veprën penale të Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore.

61. Vepra penale e Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore parasheh dënimin prej gjashtë muaj deri në pesë vjet burgim. Pas dhënies së alternativave për rregullat e përgjithshme të përmendura në nenin 64 të KPK-së për llogaritjen e dënimeve, kolegji i apelit konsideron se

dënimi i duhur për tu shqiptuar ndaj të akuzuarit është pesë vjet burgim. Koha e të akuzuarit e kaluar në paraburgim do të llogaritet në dënimin e tij.

62. Fakti se i akuzuari K.P. nuk ka pasur dënime të mëhershme në kohën kur Gjykata e Qarkut në Pejë nxori aktgjykimin në mënyrë të qartë është balancuar me këto rrethana rënduese: akti penal rezultoi në dëm të lartë material prej 16.800 EUR për Fondin Garantues; rregullimi specifik i krimit në veçanti përfshirja e personave të tjerë dhe skema e diskutuar e cila ishte shfrytëzuar për të mashtruar Fondin Garantues të Kosovës; pozita e të akuzuarit e ndikimit në bashkë të pandehurin L. P., një ish jurist stazhier nën mbikëqyrjen e tij, të cilën i pandehuri K.P. e shfrytëzoi në favor të tij.

63. Kolegji i apelit më tej konsideron se nevoja për të shqiptuar dënimin maksimal është në veçanti e rëndësishme për të përmbushur qëllimin e dënimin, që – përveç rehabilitimit të kryerësit – është parandalim i përgjithshëm dhe individual (neni 34 i KPK-së). Republika e Kosovës është dëmtuar rëndë nga praktikat e zhvilluara të vazhdueshme korruptuese midis entiteteve shtetërore, përfshirë gjyqësorin. Lufta kundër korrupsionit nuk kërkon dërgimin e sinjaleve të fuqishme vetëm tek kryerësit por edhe tek shoqëria kosovare me qëllim të demonstrimit të asaj se këto krime do të ndiqen dhe shkelësit do të përballen me drejtësinë në konditat më të fuqishme.

64. Kolegji i apelit refuzon argumentin e parashtruar nga i pandehuri K.P. se trupi gjykues tejkaloi autoritetin e tij në gjetjen se profesioni i gjyqtarit përbën “kryerjen e funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik” sipas nenit 56 të KPK-së. Kolegji i apelit është i mendimit se “kryerja e funksioneve në shërbimin publik” duhet të interpretohet gjerësisht, për të mbuluar edhe gjyqësorin. Megjithatë sikurse është shpjeguar edhe më lart, kolegji i apelit vendosi të zbatoj kodin e vjetër penal, ligj në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale. Prandaj dënimi plotësues i ndalimit të ushtrimit të funksionit në administratën publike ose në shërbimin publik nuk mund të shqiptohet në lëndën aktuale sepse sipas kodit të vjetër penal të Kosovës, vepra penale e Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore nuk e përfshinë mundësin e dënimin me burgim “deri në dhjetë vjet”.

66. Propozimi i avokatit mbrojtës Gëzim Kollçaku për të ndërprerë paraburgimin e të pandehurit K. P. refuzohet si i pabazuar.

67. Prandaj u vendos si në dispozitiv.

Përgatitur në gjuhën angleze, gjuhë e autorizuar. Aktgjykimi i arsyetuar u kompletua dhe nënshkrua më nëntor 2013.

Kryetarja e kolegjit

Annemarie Meister

Anëtari i kolegjit

Anëtarja e kolegjit

Tore Thomassen

Tonka Berisha

Zyrtari ligjor i EULEX-it

Clemens Mueller

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR 1122/2012
25 prill 2013